

VENDIM
Nr. 207, datë 17.8.2022

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN KORRIK 2022**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.8.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1458 prot., datë 10.8.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022”, konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 5506 prot., datë 4.8.2022, protokolluar në ERE me nr. 1441 prot., datë 8.8.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,28 lekë/kwh për muajin korrik 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 5505 prot., datë 4.8.2022, protokolluar në ERE me nr. 1442 prot., datë 8.8.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekësh/kwh për muajin korrik 2022, ku janë përfshirë edhe kostot e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, 10 kV, si dhe 6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF).

- Mbështetur në nenin 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe do të faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe të akteve të tjera në fuqi.

- Në lidhje me komponentët e tjerë të përllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF për muajin korrik 2022 evidentojmë, se, në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët, që furnizohen nga FMF-ja për muajin korrik 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si vijon:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Korrik 2022				
KORRIK 2022			Nivelet e tensionit	
			35 kV	20/10/6 kV
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	26.93	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.81	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+ TSHt+ CA		Leke/kWh	31.20	18.26

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022 do të jetë:

- 31.20 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2022, prej:

- 31,20 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18,26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti